



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 5 datë 30/01/1998

**PER
SHPERBLIMIN E KESHILLIT TE KULTURES SE BASHKISE
TIRANE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Arsimit dhe Sporteve për shpërblimin e Këshillit të Kulturës së Bashkisë, organ konsultativ pranë Bashkisë së Tiranës, në bazë të Vendimit Nr.540, dt.21.12.1992 dhe Nr.298, dt.21.06.1993 të Këshillit të Ministrave dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sporteve dt.28.05.1993,

V E N D O S I

1. Të financojë shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Kulturës së Bashkisë në shumën prej 13.500 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI